



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L -002**

**PËR NDALIMIN E BASHKIMIT NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA  
JASHTË TERRITORIT TË VENDIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDALIMIN E BASHKIMIT NË KONFLIKTE TË  
ARMATOSURA JASHTË TERRITORIT TË VENDIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Më qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare, ky ligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj çdo personi i cili merr pjesë apo organizon, rekruton, financon, nxit, udhëheqë apo trajnon personat ose grupe të personave me qëllim të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individuale, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen ndaj shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë shtetësinë e shtetit të huaj, dhe janë pjesë e ushtrisë ose formacionit ushtarak të tyre, ose

shërbejnë në formacionet ushtarake nën kontrollin e qeverive ndërkombëtarisht të pranura apo organizatave ndërkombëtare.

3. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për strukturat e sektorit të sigurisë të Republikës së Kosovës, të cilat në bazë të ligjit veprojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

### **Neni 3**

#### **Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës**

1. Kushdo që organizon, rekruton, udhëheqë apo trajnon personat ose grupe të personave me qëllim të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite.

2. Kushdo që në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijani apo ka bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdoren tërësisht apo pjesërisht për të kryer veprën penale të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite.

3. Kushdo që merr pjesë në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës, dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite.

4. Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, xhirimeve audiovizuale, duke përfshirë dhe mos u kufizuar edhe në rrjetet sociale ose në çfarëdo forme tjetër të komunikimit, thërret ose nxit të tjerët për kryerjen e veprave penale të përcaktuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

5. Fshehja apo moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale, apo veprës penale të kryer të përcaktuar me këtë nen dhe kryesve të saj dënohet me burgim gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

6. Kushdo që strehon kryesin e veprës penale të përcaktuar me këtë nen ose ndihmon atë në shmangien e zbulimit ose arrestimit përmes fshehjes së mjeteve, provave ose në ndonjë mënyrë tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e arrestimit, ekzekutimin e dënimit, dënohet prej gjashtë (6) muaj deri në (5) pesë vite.

7. Kryesi i veprës penale të përcaktuar me këtë nen, i cili me zbulimin e grupit tek organet kompetente të ndjekjes penale, eviton kryerjen e veprës penale ose e zbulon grupin tek organet kompetente të ndjekjes penale, para kryerjes së veprës penale, dënohet me burgim deri në tre (3) vite apo edhe mund të lirohet nga dënimi.

**Neni 4**  
**Procedura për hetimin dhe ndjekjen penale**

1. Vepra penale e përcaktuar me këtë ligj konsiderohet krim i rëndë në kuptim të nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale.
2. Ndjekja penale e kryesve të veprës penale të përcaktuar me këtë ligj është në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
3. Procedura për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprës penale të përcaktuar me këtë ligj dhe shqiptimi i dënimit, zhvillohet në bazë të Kodit të Procedurës Penale.
4. Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të parapara në Kodin e Procedurës Penale, mund të zbatohen gjatë hetimit dhe ndjekjes penale të veprës penale të kryer, sipas këtij ligji.
5. Dispozitat për sekuestrim dhe konfiskim siç janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale mund të zbatohen përshtatshëm për veprën penale të përcaktuar me këtë ligj.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -002**  
**12 mars 2015**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Kadri VESELI**